

# **POLICIA, RENDI, SIGURIA DHE MARRËDHËNIET ME KOMUNITETIN**

**Gjetje dhe rekomandime për politika që përmirësojnë  
punën e Policisë së Shtetit Shqiptar në lidhje me  
policimin në komunitet - Prill 2014**

**TIRANE, PRILL 2014**



## SHKURTIMET

<b>BE</b>	<b>Bashkimi Evropian</b>
<b>EMP</b>	<b>Ekipi i Menaxhimit të Programit</b>
<b>IDRA</b>	<b>Instituti për Kërkime dhe Alternativa Zhvillimi</b>
<b>ICLA</b>	<b>Instituti për Ndryshim dhe Lidership në Shqipëri</b>
<b>ISPL</b>	<b>Instituti për Studime Publike &amp; Ligjore</b>
<b>MPB</b>	<b>Ministria e Punëve të Brendshme</b>
<b>OSHC</b>	<b>Organizata të Shoqërisë Civile</b>
<b>PSH</b>	<b>Policia e Shtetit Shqiptar</b>
<b>QBTL</b>	<b>Qendra për Biznes Teknologji dhe Lidership</b>
<b>SACP</b>	<b>Mbështetja Suedeze për MB/PSH për Policimin në Komunitet</b>

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Qëllimi i raportit është ti ofrojë MPB dhe PSH rekomandime të cilat mund të merren parasysh gjatë procesit të reformave të cilat përmirësojnë punën e PSH në tërësi dhe në mënyrë të veçantë Policimin ndaj Komunitetit.

Për të ofruar rekomandime të bazuara në informacion të asnjanshëm dhe tërësor, raporti u bazua në një sërë studimesh të cilat japin pritshmëritë që kanë institucione dhe grupime të ndryshme qytetarësh mbi punën e PSH. Gjatë periudhës Mars - Prill 2014 u ndërmorën dhe shtatë studime të tjera nga IDRA dhe ICLA të cilat sollën përvojat e grupeve shoqërore dhe institucioneve të ndryshme nga ndërveprimi me stafin e Policisë së Shtetit Shqiptar (PSH) si dhe perceptimin që ata kanë mbi sigurinë, rendin dhe punën e PSH.

Analiza e të gjitha gjetjeve ka në qendër prioritetet themelore të reformimit të PSH<sup>1</sup>

1. Transformimin institucional - organizativ<sup>2</sup> që i referohet ndryshimeve të brendshme të menaxhimit të PSH si dhe krijimit të një kulture bashkëkohore menaxhimi dhe të mbështetur me infrastrukturën më të përparuar<sup>3</sup>

2. Policimin në komunitet si dhe partneritetin me komunitetin<sup>4</sup>

Gjetjet i ofrojnë Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe PSH të dhëna cilësore dhe sasiore mbi pikat e forta dhe të dobëta dhe mundësitë që ka policia në terren për t'u përmirësuar dhe për t'i shërbyer sa më mirë qytetarëve të vendit.

Për të ofruar një pamje sa më të plotë, studimi bën dhe një analizë të ambientit strategjik ku ndërvepron PSH si dhe të strategjive dhe politikave ekzistuese.

Ky raport është bazuar në:

a. Rezultatet e vlerësimit dhe perceptimit ndaj punës së policisë së shtetit nga grupe të shoqërisë dhe institucione të cilat ndërveprojnë me policinë të marra gjatë periudhës Mars - Prill 2014. Specifikisht janë anketuar: i) 48 Institucione Publike dhe 16 Institucione jo publike në nivel lokal dhe qendror; ii) 28 përfaqësues të mediave lokale dhe kombëtare, iii) 8 Grupe të fokusuara me një total prej 56 pjesëmarrësish, përfaqësues të grupeve të ndryshme shoqërore dhe iv) 179 Qytetarë që kanë kryer denoncim në polici. Këto perceptime nuk janë përfaqësuese në nivel kombëtar, por janë të rëndësishme për të njohur opinionin e këtyre grupeve që ndërveprojnë me PSH të anketuara në momentin e anketimit.

<sup>1</sup> Strategjia e Policisë së Shtetit 2007 - 2013

<sup>2</sup> <http://www.punetebrendshme.gov.al/al/prioritetet/artikuj>

<sup>3</sup> [http://www.asp.gov.al/index.php?option=com\\_content&view=article&id=182&Itemid=125&lang=sq](http://www.asp.gov.al/index.php?option=com_content&view=article&id=182&Itemid=125&lang=sq)

<sup>4</sup> [http://www.asp.gov.al/index.php?option=com\\_content&view=article&id=182&Itemid=125&lang=sq](http://www.asp.gov.al/index.php?option=com_content&view=article&id=182&Itemid=125&lang=sq)

**b. Inventarizimin e gjetjeve nga studimet e mbështetura nga Programi SACP të kryera nga organizatat jo-qeveritare gjatë vitit 2012-2013.**

**c. Hulumtimet mbi dokumentat strategjike zyrtar<sup>5</sup> të publikuara - si p.sh. strategji dhe plan-veprime në lidhje me policinë dhe policimin në komunitet**

**d. Mendimet e dhëna në takimin konsultativ në Tiranë, 2 maj 2014 nga përfaqësues të MPB, PSH, Ministrive të linjës, përfaqësuesve të institucioneve ndërkombëtare dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile.**

Gjatë analizave të dokumentave strategjik por dhe në takime me institucione të ndryshme publike dhe jo publike del se institucionalizimi i reformave në lidhje me policimin komunitar dhe zbatimi i ndryshimeve në mënyrë që ato të jenë të qëndrueshme vazhdon të jetë një sfidë për MPB dhe për PSH. Deri më sot janë zbatuar disa reforma dhe plane veprimi në lidhje me policimin në komunitet, por ato nuk kanë qenë pjesë e një strategjie të mirëfilltë. *Raporti rekomandon zhvillimin e një strategjie të mirëfilltë për policimin në komunitet me objektiva dhe aktivitete konkrete për realizimin e kësaj filozofie në shërbimin policor.*

Studimi gjen që pothuajse në të gjitha grupet e anketuara ka një perceptim pozitiv në lidhje me përmirësimin e performancës së policisë së shtetit në periudhën 4 mujore janar - Prill 2014.

Disa nga aspektet për vlerësimin e mirë të performancës që këto grupe i kanë dhënë rëndësi në vlerësim përfshijnë: komunikimi i përmirësuar i oficerëve të policisë me qytetarët<sup>6</sup>, përfshirja e një numri më të madh të femrave të cilat kanë një komunikim profesional me qytetarët, vendosja në terren, paraqitja dhe sjellja e profesionalizimi i policisë rrugore, puna e kryer në tërësi nga Policia Kufitare, lehtësia për të kontaktuar policinë kur qytetarët kanë nevojë të denoncojnë si dhe ndjekja e çështjeve dhe informacioni i dhënë për çështjet e denoncuara.

Sipas studimeve të ndryshme të shqyrtuara, besimi ndaj PSH është i ndryshëm në grupime të ndryshme p.sh a) IDRA Mars 2014 Anketa mbi kontaktet me policinë (129) tregon se të anketuarit (63% kanë besim tek PSH në përgjithësi, b) Të anketuarit (drejtues të automjeteve IDRA Mars 2014) kanë 40% besim tek PSH, c) pjesëmarrësit në fokus grupe (IDRA Mars 2014) shprehën se nuk kanë besim të plotë tek PSH kurse d) përfaqësues të komunitetit Rom dhe Egjiptian në fokus grupe (IDRA Mars 2014) - pohojnë se efektivët e

<sup>5</sup> Shiko seksionin { Bibliografia)

<sup>6</sup> IDRA Fokus Grupe Mars 2014 & ICLA Intervista me institucione të ndryshme Mars - Prill 2013

**policisë sillen në mënyre jo profesionale kundrejt tyre dhe për këtë arsye, besimi tek PSH për këto komunitete është në nivele minimale.**

**Nga sa më sipër shikohet se ndërsa ka një tendencë pozitive në përmirësimin e sipër mbi perceptimin ndaj punës që kryen PSH, ka akoma punë për tu bërë që të rritet besimi sidomos për grupime të ndryshme.**

**Tek gjetjet raporti i bën referencë rezultateve të anketave të ndryshme mbi perceptimin, besimin dhe opinionet që kanë grupime të ndryshme mbi punën e PSH. Duke qenë se këto anketa janë kryer me metodologji të ndryshme ato nuk janë të krahasueshme dhe për këtë arsye ato kanë nevojë të përsëriten periodikisht me të njëjtën metodologji. *Nisur nga kjo raporti rekomandon vendosjen brenda strategjisë, zbatimin e një sistemi të detajuar (periodik) të matjes së performancës dhe perceptimeve publike.***

**Studimi i referohet të dhënave sasiore dhe cilësore përgjatë viteve 2013 - 2014, dhe na tregon që ka një numër të madh çështjesh që mbeten për tu përmirësuar në lidhje me:**

- a) një qasje të re të shërbimit në komunitet dhe ndaj qytetarëve për të përmirësuar sigurinë, rendin, marrëdhëniet, shërbimin dhe komunikimin e PSH me komunitetin dhe grupe të veçanta shoqërore.**
- b) përmirësimin e brendshëm organizativ dhe të burimeve njerëzore, financiare dhe materiale në PSH si dhe**
- c) përmirësimin dhe bashkërendimin e punëve të PSH me komunitetin dhe partnerëve të tjerë të shoqërisë civile.**
- d) forma dhe qasje të reja të komunikimit dhe zbatimin e një strategjie komunikimi që do të rritin ndërgjegjësimin e publikut për rolin real të policisë dhe efikasitetin e saj si dhe do të përmirësojnë në tërësi imazhin e PSH.**

## II. REKOMANDIME

Rekomandimet janë përgatitur bazuar jo vetëm në çështjet e dala nga anketimet e IDRA dhe ICLA gjatë 2014, por reflektojnë një spektër më të gjerë gjetjesh dhe rekomandimesh të dala nga studime të mëparshme të kryera që nga viti 2012 e deri në 2014 . Kjo për arsye se gjetjet e këtyre studimeve vazhdojnë të jenë të vlefshme dhe aktuale për të përmirësuar performancën e PSH si dhe imazhin e saj në publik.

**REKOMANDIMI 1 - Krijimi dhe zbatimi një strategjie të plotë dhe të mirëfilltë për policimin në komunitet.**

*1.1. Zbatimi i strategjisë duhet të përfshijë masa konkrete në reformimin e sistemit të brendshëm të PSH në të gjitha strukturat si ato drejtuese ashtu dhe zbatuese. Këto masa do të sigurojnë që ndryshimi i pritshëm nga reforma të bëhet pjesë natyrale e përpjekjeve të përditshme të vetë policisë.*

**REKOMANDIMI II - Përmirësimi i bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punëve ndërinstytucionale si dhe përmirësimi i bashkëpunimit mes policisë dhe partnerëve të shoqërisë civile.**

**REKOMANDIMI III - Për përmirësimin e kushteve të punës së policisë dhe infrastrukturës së saj.**

## **REKOMANDIMI 1 - Krijimi dhe zbatimi një strategjie të plotë dhe të mirëfilltë për policimin në komunitet.**

**1.1. Zbatimi i strategjisë duhet të përfshijë masa konkrete në reformimin e sistemit të brendshëm të PSH në të gjitha strukturat si ato drejtuese ashtu dhe zbatuese. Këto masa do të sigurojnë që ndryshimi i pritshëm nga reforma të bëhet pjesë natyrale e përpjekjeve të përditshme të vetë policisë.**

Për të siguruar këtë, PSH duhet të rishikojë që sistemet e rekrutimit, matjes së performancës, trajnimit, kualifikimeve, shpërblimeve dhe strategja e komunikimit të reflektojnë më së miri policimin e orientuar në komunitet.

Kjo mund të realizohet nëpërmjet zbatimit të disa hapave konkrete shoqëruese:

- Në radhë të parë prioritizimi i çështjeve që propozon reforma duke nisur nga ato që janë njëkohësisht më të rëndësishme dhe urgjente për të siguruar parandalimin dhe uljen e kriminalitetit, sigurinë dhe rendin në vend.
- Krijimi i një sistemi komunikimi të brendshëm me të gjitha institucionet dhe njësitë e policisë në lidhje me reformën dhe masat e zbatimit për t'i informuar dhe për të marrë mendimet e tyre
- Rritja e delegimit dhe marrja e përgjegjësi nga nivelet më të ulëta të hierarkisë (kjo e siguruar dhe nëpërmjet përmirësimit të kapaciteteve njerëzore të punonjësve të PSH si dhe rënies në marrjen e vendimeve vetëm nga maja e organizatës)
- Krijimi dhe përforcimi i kapaciteteve në polici me qasje policimin në komunitet. Kjo mund të realizohet përmes përforcimit të strukturave për parandalimin e krimit dhe prishjen e rendit si dhe krijimin ose përmirësimin e aftësive të punonjësve të PSH me qasje policimin në komunitet nëpërmjet:
  - ❖ Përfshirjes së aftësive për policimin në komunitet në kriteret e rekrutimit të punonjësve të rinj
  - ❖ Përfshirjes në sistemin e matjes së performancës dhe në sistemin e shpërblimeve individuale kriteret vlerësimi për matjen e nivelit të njohurive dhe formave të të sjellurit të punonjësve të policisë sipas filozofisë së policimit në komunitet. (në nivel individual dhe njësie).
  - ❖ Ngritjes së një programi trajnimi të fokusuar ndaj policimit në komunitet.

**1.2. Strategjia duhet të sigurojë masa konkrete për përfshirjen dhe bashkëveprimin e komunitetit si pjesëmarrës, kontribues dhe përfitues i policimit në komunitet.**

Për këtë, duhet të merren masa konkrete për:

- Socializimin dhe komunikimin e konceptit të policimit në komunitet në nivel lokal/komunitar. Është me rëndësi që informacioni të komunikohet dhe të përçohet në

mënyrë të thjeshtë, të qartë dhe të jetë i aksesueshëm nga të gjithë qytetarët në komunitetet e tyre.

- Konsultimin me komunitetin nëpërmjet një plani të mirë përcaktuar me afate dhe metodologji me struktura të ndryshme ekzistuese.
- Rritjen e rolit aktiv të komunitetit për të parandaluar krimet dhe siguruar rend dhe qetësi - Policimi në komunitet nënkupton që policia ndihmohet në mënyrë aktive nga komuniteti për të kryer funksionin parandalues të krimit si dhe siguruar rendin dhe qetësinë. Në këtë kuadër merr rëndësi dhe Përmirësimi i Partneritetit me Publikun e gjerë duke krijuar një strukturë përgjegjëse të PSH në qendër me këto detyra:
  - ❖ udhëheqje metodologjike për drejtoritë e qarqeve në hartimin e planeve të veprimit për policimin në komunitet.
  - ❖ monitorim i centralizuar i zbatimit të planeve të veprimit nga struktura përgjegjëse.
  - ❖ raportim periodik e publik për zbatimin e planit të integruar të veprimit.
  - ❖ koordinim i veprimeve për zbatimin e dekoncentruar të planit të veprimit nga drejtoritë në qarqe.
  - ❖ zhvillimi dhe përdorimi i metodave për monitorimin e zbatimit të aktiviteteve dhe vëzhgimin periodik të perceptimit të publikut për efikasitetin e ndërveprimit të policisë me komunitetin e gjerë.
  - ❖ caktimi i një pike fokale në çdo komisarjat për çështjet e policimit në komunitet.

*1.3. Krijimi dhe zbatimi i një sistemi të detajuar (periodik) të matjes së perceptimeve mbi performancën e policisë nga publiku si pjesë e integruar e strategjisë së re të policimit në komunitet.*

Ky sistem i matjes së perceptimeve duhet të mbështetet si nga PSH ashtu dhe nga aktorë të ndryshëm të OSHC-ve për të sjellë vlerësime të jashtme që të informojnë MPB dhe PSH mbi masat që duhet të merren për përmirësimin e punës. Të dhënat duhet të jenë të disagreguara në sa më shumë detaje për të adresuar çështje që vijnë nga grupime të ndryshme demografike si gjinia, mosha, rajoni, niveli i arsimit, etnia, etj.

*1.4. Një strategji e re komunikimi dhe përfshirja e masave konkrete të komunikimit strategjik brenda strategjisë së re të policimit në komunitet.*

Qasja e re e komunikimit duhet të përfshijë forma të reja të komunikimit si me komunitetin e gjerë ashtu dhe me palët e tjera të shoqërisë me anë të një qasjeje të re komunikimi. Këto forma duhet të jenë konkrete, të zbatueshme dhe të matshme.



Rekomandimet e Strategjisë së Komunikimit për PSH të propozuara nga COMPORT si dhe ato të paraqitura nga Donatorë të ndryshëm (OSCE, ICITAP, PAMECA, SACP) dhe nga shoqëria civile të kthehen në masa të zbatueshme dhe të matshme brenda Strategjisë së re, të tilla si:

- Hartimi dhe miratimi i një manuali për prezantimin në media të policimit në komunitet. Manuali mund të përfshijë formate dhe metoda komunikimi për zhvillimin e fushatave ndërgjegjësuese , të fushatave për sigurinë publike, për sigurinë e trafikut, për informimin e qytetarëve mbi rrugët e ankimit në polici etj;
- Përmirësimi i imazhit publik të policisë duke përforcuar marrëdhëniet me komunitetin, duke vënë theksin në aspektet pozitive, gatishmërinë dhe shërbimet që Policia e Shtetit ofron për komunitetin në përgjithësi dhe për rastet e dhunës në familje në veçanti dhe tek profesionalizmi, paanshmëria dhe zbatimi i etikës nga punonjësit e saj; Për këtë do të ndihmojë dhe përmirësimi i strukturave pritëse në komisariatet e policisë të cilat duhet të reflektojnë standard të lartë shërbimi. *Këto struktura pritëse do të krijojnë një impakt të rëndësishëm për imazhin e policisë në publik.* Një qytetar ruan në kujtesë shërbimin e mirë më shumë sesa problemin që e ka çuar aty.
- Rritja e ndërgjegjësimit për rolin real të policisë dhe efikasitetin e saj aktual përmes:
  - ❖ Rritjes së numrit të aktiviteteve të policisë në media (televizione dhe programe radiofonike, artikuj në gazeta e revista). Në këtë mënyrë do të shfaqet saktësisht dhe plotësisht roli i policisë në përgjigje ndaj çështjeve të sigurisë, rendit, parandalimit dhe ndalimit të krimeve, dhunës në familje, etj, duke siguruar shpërndarjen e informacionit të drejtë tek audienca. Duke qenë se media më e ndjekur dhe burimi kryesor i informacionit mbetet televizioni, është e preferueshme të krijohen marrëveshje me televizionet kombëtare dhe ato lokale për të krijuar hapësira televizive të herë pas hershme për policinë dhe çështjet e lart përmendura.
  - ❖ Zhvillimit të një faqeje informative të posaçme brenda faqes web të PSH. Kjo faqe të ofrojë informacion konkret, të detajuar dhe praktik; këshilla mbi parandalimin e krimit, ruajtjes së rendit, dhunës në familje etj; të prezantojë rolin e policisë dhe informacione të tjera të nevojshme rreth shërbimeve në dispozicion, duke pasur si fokus veçanërisht të rinjtë, si përdorues kryesor të internetit dhe përcjellës shumë të mirë të informacionit.
  - ❖ Organizimit të aktiviteteve brenda ambienteve të komisariateve të policisë ku të ftohet komuniteti dhe përfaqësues të institucioneve e organizatave të ndryshme që punojnë në këtë fushë në raste ngjarjesh specifike, për të prezantuar rolin, risitë dhe arritjet e policisë.
  - ❖ Të nxitet shfaqja e spoteve publicitare në mediat audiovizive kundër dhunës në familje dhe formave të mbrojtjes së viktimës.

- ❖ Të nxiten bisedat në studio televizive e radiofonike me temë problematikat sociale dhe marrëdhëniet në familjen bashkëkohore dhe solidaritetin familjar e komunar.
- ❖ Të rishikohen tekstet shkollore në të gjitha nivelet e arsimit dhe të futen programe dhe kurrikula të veçanta që kanë të bëjnë me të jetuarin në komunitet, çështje të sigurisë dhe të rendit, çështje të parandalimit të krimit dhe dhunës dhe shkaqeve që i sjellin këto fenomene në komunitet dhe familje, çështje të sigurisë në rrugë dhe trafik, si dhe çështje që tregojnë rolin e policisë dhe marrëdhëniet e komunitetit me policinë.

*1.5. Strategjia duhet të përmbajë jo vetëm prioritetet dhe fushat kryesore të ndërhyrjeve, por dhe një plan veprimi të detajuar me:*

- objektiva konkrete dhe të matshme,
- të dhëna bazë si pikënisje për referencë për ndërhyrjet (baseline),
- përgjegjësi konkrete nga institucionet si në nivel qendror ashtu dhe lokal,
- afate konkrete kohore,
- buxhet për të mbështetur veprimet,
- mjete verifikimi dhe procese monitorimi për të treguar se si do të monitorohen dhe maten rezultatet

Planet e veprimit në nivel qarku të jenë kapituj të planit të integruar dhe planet e veprimit të njësive dhe departamenteve të jenë të lidhura respektivisht.

**REKOMANDIMI II - Përmirësimi i bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punëve ndërinstitucionale si dhe përmirësimi i bashkëpunimit mes policisë dhe partnerëve të shoqërisë civile.**

Megjithëse PSH perceptohet të ketë një bashkëveprim dhe koordinim relativisht të mirë me institucionet e ndryshme shtetërore, në kuadrin e policimit në komunitet, potenciali i këtij bashkëpunimi duhet parë shumë më i gjerë se kaq. Për të bërë të mundur shfrytëzimin e plotë të këtij potenciali, rekomandohen 2 (dy) linja veprimi:

1. *të nxitet interesi i partnerëve shtetërorë për forma të reja bashkëpunimi me policinë;*
  2. *të formalizohet ligjërisht detyrimi i partnerëve shtetërorë për t'u përfshirë aktivisht në proceset e rëndësishme të planifikimit dhe monitorimit të policimit në komunitet.*
- Gjithashtu rekomandohet ngritja e një komiteti koordinues për policimin në komunitet, sipas modelit të krijuar nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 334, datë 07.02.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij.”
  - Një formë tjetër bashkëpunimi mund të konsiderohet dhe organizimi në mënyrë sistematike i trajnimeve të përbashkëta me punonjës të institucioneve të ndryshme, që merren me çështje ndërinstitucionale. P.sh. në rastin e dhunës në familje (policia, bashkia, gjykata, prokuroria, zyra e përmbarrimit, shkollat, qendra shëndetësore etj.) duhet të jenë të fokusuar tek ndryshimet ligjore dhe strukturat e reja çka do të sillte rritje të ndërgjegjësimit për rolin e gjithsecilit, kuptimin e pikëpamjeve dhe shqetësimeve përkatëse si dhe forcimin e marrëdhënieve ndërinstitucionale.
  - Për përmirësimin e bashkëpunimit mes policisë dhe partnerëve të shoqërisë civile rekomandohet:
    - ❖ *PSH duhet të jetë aktive në kërkimin dhe zbatimin e formave praktike të ndërveprimit me OSHC-të nëpërmjet formave të ndryshme si p.sh. marrëveshje dhe memorandume bashkëpunimi të lidhura me detyra dhe objektiva konkrete nga secila palë.*
    - ❖ *Çdo drejtori e policisë në qark duhet të ndërtojë një bazë të dhënash të plotë me emrat, adresat dhe pikat e kontaktit të organizatave jo qeveritare aktive në fusha të tilla si dhuna në familje, të drejtat e grave, të drejtat e të miturve, trafiqet, gjakmarrja etj. Konsultimi i këtyre subjekteve të bëhet sipas një kalendari të mirë përcaktuar vjetor dhe në mënyrë publike;*
    - ❖ *Çdo drejtori e policisë në qark duhet të zhvillojë këshillime të thjeshta dhe periodike me përfaqësues të biznesit në qark;*
    - ❖ *Policia duhet të raportojë periodikisht dhe publikisht për ecurinë e saj në zbatimin e memorandumeve.*

**REKOMANDIMI III - *Për përmirësimin e kushteve të punës së policisë dhe infrastrukturës së saj.***

Duke qenë se dokumente strategjike me rekomandime specifike për përmirësimin e kushteve të punës së policisë dhe infrastrukturës janë të disponueshme nga MPB dhe PSH, nuk duam të bëjmë një përsëritje të këtyre rekomandimeve. Gjithsesi, siç rezulton dhe nga gjetjet, kushtet e punës dhe infrastruktura janë faktorë të rëndësishëm për tu konsideruar si pjesë e strategjisë së re. Kjo sepse këto faktorë ndikojnë jo vetëm në performancën dhe jetën profesionale të punonjësve të policisë (në zbatimin e punës së tyre të përditshme si dhe moralin dhe motivimin e punonjësve), por kanë një ndikim shumë të prekshëm tek perceptimi i qytetarëve dhe anëtarëve të komunitetit në lidhje me punën që kryen dhe shërbimet që ofron policia.

Në këtë kuadër do të rekomandonim që MPB dhe PSH të përfshinte në plan veprimin për policimin në komunitet masat konkrete dhe mjetet e verifikimit dhe të matjes së progresit dhe arritjeve në lidhje me përmirësimin e ambienteve dhe infrastrukturës, pajisjet, trajtimin financiar si dhe planet për riorganizimin dhe funksionimin e strukturave të PSH.

**Tabela përmbledhëse e të dhënave demografike të anketimeve, intervistave dhe fokus grupe (Mars - Prill 2014)**

	ANKETA	ORGANIZATA	PERIUDHA	METODOLOGJIA	NR I PJESËMARRËSVE	TIPOLOGJIA	RRETHET
1	Intervista me përfaqësues të Institucioneve publike dhe jo publike	ICLA	Mars – Prill 2014	Intervista gjysmë të strukturuar	64 përfaqësues	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përfaqësues te institucioneve publike, jo-publike (NGO)</li> <li>• Donatorë dhe Biznese Ministri linje</li> <li>• Kryetar komunash</li> <li>• Kryeplak</li> <li>• Drejtori Rajonale Arsimore</li> <li>• Spitale rajonale</li> <li>• Shkolla të mesme</li> <li>• Bashki</li> <li>• Prefektura</li> <li>• Prokurori</li> <li>• Drejtori rajonale të shërbimit social</li> <li>• Njësi për mbrojtjen e familjes</li> <li>• Komisioner për të drejtat e njeriut</li> <li>• Zyra e avokatit të popullit</li> <li>• Drejtori e koordinimit dhe zhvillimit në qarqe</li> <li>• Zyra të gjendjes civile</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tiranë,</li> <li>• Durrës</li> <li>• Shkodër, Korçë,</li> <li>• Fier,</li> <li>• Vlorë</li> <li>• Sarandë</li> <li>• Dibër</li> <li>• Elbasan</li> <li>• Gjirokastrë</li> </ul>
2	Intervista me përfaqësues të medias	ICLA	Mars – Prill 2014	Intervista gjysmë të strukturuar	28 përfaqësues	Gazetarë <ul style="list-style-type: none"> <li>• Media e shkruar</li> <li>• Televizion</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tiranë,</li> <li>• Durrës</li> <li>• Shkodër, Korçë,</li> <li>• Fier,</li> <li>• Vlorë</li> <li>• Sarandë</li> <li>• Dibër</li> <li>• Elbasan</li> </ul>

	ANKETA	ORGANIZATA	PERIUDHA	METODOLOGJIA	NR I PJESËMARRËSVE	TIPOLOGJIA	RRETHET
							<ul style="list-style-type: none"> <li>• Gjirokastrë</li> </ul>
3	Anketimi me viktima të krimit	IDRA	Mars – Prill 2014	Anketim	179 intervista	Qytetarë që kishin kryer denoncim ne polici	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tiranë,</li> <li>• Shkodër, Korçë,</li> <li>• Fier,</li> <li>• Lushnjë, Lezhë</li> </ul>
4	Anketimi i personave që kanë pasur përvoja me policinë e trafikut rrugor	IDRA	Mars 2014	Anketim	300 intervista	Drejtues automjesh, rreth 78% e të anketuarve përbëhen nga drejtues autoveturash (jo taksi)	12 qarqe në zona urbane (qytete),
5	Anketimi me persona që kanë telefonuar tek 129	IDRA	Mars 2014	Anketim me telefon	300 intervista	Persona që kanë kontaktuar numrin e policisë (129) gjatë tremujorit të parë të vitit 2014.	Tiranë
6	Anketimi me persona që kalojnë nëpër pikat e kontrollit kufitar	IDRA	Mars 2014	Anketim	305 intervista	Persona që kalojnë nëpër pikat e kontrollit kufitar dhe që kanë pasur ndërveprim me stafin e Policisë së Shtetit gjatë 12 muajve të fundit shtetas shqiptar dhe të huaj (raporti~2:1).	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Aeroporti Rinas;</li> <li>• Porti Detar Durrës;</li> <li>• Kakavijë;</li> <li>• Muriqan;</li> <li>• Qafë Thanë.</li> </ul>
7	Fokus Grupe	IDRA	Mars – Prill 2014	Fokus Grup	8 takime 56 pjesëmarrës	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Popullatë e përgjithshme; Grup-mosha 18-56 vjeç</li> <li>• Të rinj; Grup-mosha 18-24 vjeç</li> <li>• Të rinj nga Zona rurale</li> <li>• Mësues/Prindër; Grup-mosha 18-56 vjeç</li> <li>• Popullsi Rome/Egjiptian; Grup-mosha 18-56 vjeç</li> <li>• Popullsi zona rurale Grup mosha 25-56</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tiranë</li> <li>• Kamzë-Bathore</li> <li>• Popullsi zona rurale Tiranë</li> </ul>